Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

---

**Prizren, 21.09.2016**

**Këshilli për Trashëgimi Kulturore**
**i Qendrës Historike të Prizrenit**

# REKOMANDIM

Investitori, **Halil Elshani**, me numrin e lëndës: 04-353-64880, me të cilën ka kërkuar prej Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor leje për ndertimin e objektit, shtepi individuale per banim në ngastrën kadastrale me numër 3611-0, ZK-Prizren.

**Këshilli pas shqyrtimit të lëndës, merr vendim për kthimin e lëndes për plotësim, për shkak të mangësive të mëdha në projekt.**
**Kërkesat dhe Rekomandimet e Këshillit jane:**

1. **Në projekt mungon përshkrimi teknik i objektit, përshkrimi teknik i dorëzuar nuk mund të quhet përshkrim teknik, në asnjë rast nuk përmenden materialet të cilat do të përdoren për ndërtimin e objektit. Pra, projektit t'i shtohet përshkrimi teknik.**

**Në përshkrimin teknik të ceken elementet dhe materialet si në vijim:**

1. **Lloji i tjegullave që do të përdoret për mbulimin e kulmit.**
2. **Dimensioni i dritareve, materiali dhe ngjyra.**
3. **Përshkrimi detal i fasadës.**
4. **Në projekt të paraqitet fasada në detaje dhe kollor, në disa dimensione.**
5. **Si dhe, arkitektura e objektit të jetë në harmoni me arkitekturën tradicionale të Prizrenit.**

**Informatë**
**Në zonën në fjalë, në bazë të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, e informojmë projektuesin se: lartësia maksimale e lejuar nga terreni natyror është 9.5 metra (maja e kulmit) dhe maja e strehës 6.5 metra nga terreni natyror. Në qoftë se e tejkalon këtë lartësi, atëhere projektit nuk do t'i jepet pëlqimi për ndërtim.**

21.09.2016

**Asyetim**

Kërkesa e parashtruar nga investitori për ndërtimin e objektit, shtëpi individuale për banim, i përket zonës së Qendrës Historike të Prizrenit. Duke u bazuar në ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit, Këshilli ka disa vërejtje ndaj kërkesës së parashtruar. Prandaj Këshilli kërkon që të plotësohen të gjitha kërkesat dhe rekomandimet e Këshillit në përpikmëri. Nëse veprohet ndryshe, atëherë investitori do të përballet me masa ligjore.

Anëtarët e Këshillit që ishin prezent;

1. Arbnor Morina / Anëtar / Kryetar
2. Igballka Rama / Anëtare / Nënkryetare
3. Artnet Haskuka / Anëtare
4. Svetlana Hadzic / Anëtare
5. Faridin Shala / Anëtar

21.09.2016

KTK, Pizren

Arbnor Morina, Kryetar.